



Ne pajtim me nenin 62.3 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr: 03/L-040 dhe nenit 85 të statusit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Ruralë nxjerr këtë:

AKTVENDIM
MBI LARTËSINË E ÇMIMIT TË SHËRBIMEVE TË KORRJE-SHIRJEVE
NË KOMUNËN E DRENASIT

I. Në bazë të propozimit nga MBPZHR me nr. 2480 të datës 30.06.2020 përcaktohet çmimi për realizimin e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit, për drithëra të bardha (grurë, tërshërë, elb, thekër) **90 €** për një hektar të korrur (**nënkuptohet se çmimi i korrje shirjeve caktohet me marrveshjenë mes të fermerëve dhe autokombanjerëve**).

II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesët Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike

III. Gjëndja teknike e autokombajnës duhet të jetë e mirë **për korrje-shirje** në mënyrë që të minimizohën humbjet e drithërave, sipas standardëve të kërkuera.

VI. Mjetet e nevojshme për shurjen e zjarrit gjatë korrje-shirjes:

Ç'do autokombanjer duhet ti këtë këto **paisje: 1. Aparatin për fikjen e zjarrit s-50-1 copë.**

2. Lopata -2 copë,

3. Kazme- 1 copë,

4. Fshisa metalike -2 copë,

5. Traktor me plug-1 traktor.

V. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vërejtje: Për mos kompletimin e këtyre pajisjeve do të merrën masa ndëshkimore.

Me nga një kopje të këtij vendimi do të njoftohën:

- Komisioni për përcjelljen e realizimit dhe zbatimin e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Drenasit,*
- Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- Të gjithë autokombajnëret që kyçen në fushatën e korrje-shirjes në territorin e Komunës së Drenasit,*
- Adminastatorët e fshatrave të Komunës së Drenasit.*

